- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]**në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
 - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallratduhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimevepër artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	Afati
1	Shtëpi me forma kafshësh shtëpiake	100			31.12.2023
2	Kamion me kafshët e pyllit	250			31.12.2023
3	Pazëll me 8 -10 mjetet e transporti	250			31.12.2023
4	Minipazëll me 5 elementë, kafshët shtëpiake	20			31.12.2023
5	Minipazëll me 5 elementë, kafshët e pyllit	20			31.12.2023

6	Minipazëll me 5 elementë, kafshët e fermës	20			31.12.2023
7	Pllaka lëkundëse me magnet	150			31.12.2023
8	Topuz muzikor me ngjyrat e ylberit	80			31.12.2023
9	Topuz muzikor në formë kafshe të buta (lepuri, ketri etj)	80			31.12.2023
10	Lupë zmadhuese	200			31.12.2023
11	Veshjet e policit	230			31.12.2023
12	Veshjet e zjarrëfikësit	230			31.12.2023
13	Veshja e mjekut	230			31.12.2023
14	Set për mjetet e mjekut	230			31.12.2023
15	Set për mjetet e dentistit	230			31.12.2023
16	Pazëll me numra	300			31.12.2023
17	Tavolinë me vegla pune	90			31.12.2023
18	Kub aktiviteti i madh	250			31.12.2023
19	Aktivitet lëvizës	100			31.12.2023
20	Dajre	100			31.12.2023
21	Daulle	150			31.12.2023
Çmimi total (Mallrat)					_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit[llojiiprocedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi(nësezbatohet):BuletiniiNjoftimevePublike [Data] [Numri]/Nr.Referencësnëfaqen e APP-së

* * *

Duke iureferuarprocedurëssëlartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emriiofertuesit të siguruar] ka derdhurnjëdepozitëpranë[emri dhe adresa e bankës] / ështëgarantuarpranë[emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me njëvlerëprej[monedha dhe vlera, e shprehurnëffjalë dhe shifra] sikushtpërsigurimin e ofertës, dorëzuarngaoperatoriilartpërmendurekonomik.

Marrimpërsipër të transferojmënëllogarinë e [emriiautoritetitkontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëvengakërkesajuaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuarshpjegime, me kushtqëkjokërkesë të përmendëmospërmëmbushjen e njëritngakushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequrose ka ndryshuarofertën, pas afatitpërfundimtarpërparaqitjen e ofertaveose para afatitpërfundimtar, nëseështëpërcaktuarkështunëdokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Nr.	Artikulli	Përshkrimi i produktit	Grupmosha	Përmasat
1	Shtëpi me forma kafshësh shtëpiake	Lodër didaktike agëtuese. Shtëpia ne ferme. Set me 10-12 pjese per te njohur kafshet e fermes. Seti përbëhet prej një objekti në formë shtëpie gjenden format e prera sipas llojit të kafshëve të ndryshme të fermës. 8-10 figura kafshesh te ndryshme te cilat mund te vendosen te format e tyre ne shtëpize. Me ngjyra te larmishme. I gjithë seti përbëhet prej material druri.	12 muaj +	Përmasat e përafërta: Gjat x gjer x lartesi: 120-140*130-150*210-230 mm Ndryshimi i mundshëm ±5%
2	Kamion me kafshët e pyllit	Lodër didaktike agëtuese. Kamjon për të futur kafshët e pyllit. Seti përbëhet nga një kamion lodër i ndërtuar me material druri, me derë nga mbrapa ndërsa në faqet anësore janë prerë format e kafshëve të ndryshme të pyllit. Kafshët e pyllit mund të vendosen secila në formën e vetë në faqet anësore të kamjonit, por mund të ngarkohen edhe brenda kamjonit për t'u transportuar.	18 muaj +	Përmasat e përafërta: Gjat x gjer x lartesi: 120-130x120-130x270-300 mm Ndryshimi i mundshëm ±5%

3	Pazëll me 8 -10 mjetet e transporti	Lodër didaktike argëtuese. Pazëll prej druri përmban 8-10 mënyra shumëngjyrëshe transporti si psh. një aeroplan, autobus, makinë, varkë, kamion, motorr, ambulancë etj. Të vegjlit duhet të përpiqen që secilën prej pjesëve prej druri me ngjyra të ndezura ta vendosin në folenë e formës së duhur në tabelën bazë. Çdo pjesë e pazëllit prej druri duhet të ketë përmasa të mjaftueshme për ta bërë më të lehtë për duart e vogla që të ngrenë, kapin, ekzaminojnë dhe zëvendësojnë.	3 vjeç +	Përmasat e përafërta: Gjat x gjer x lartesi: 280-320x220-230x15-20mm Ndryshimi i mundshëm ±5%
4	Minipazëll me 5 elementë, kafshët shtëpiake	Lodër didaktike argëtuese. Pazëll prej druri përmban 5-6 figura kafshësh të ndryshme shtëpiake Të vegjlit duhet të përpiqen që secilën prej pjesëve prej druri me ngjyra të ndezura ta vendosin në folenë e formës së duhur në tabelën bazë. Çdo pjesë e pazëllit prej druri duhet të ketë përmasa të mjaftueshme për ta bërë më të lehtë për duart e vogla që të ngrenë, kapin, ekzaminojnë dhe zëvendësojnë.	12 muaj +	Përmasat e përafërta: Gjat x gjer x lartesi: 330-340x70-80x20-25mm. Ndryshimi i mundshëm ±5%
5	Minipazëll me 5 elementë, kafshët e pyllit	Lodër didaktike argëtuese. Pazëll prej druri përmban 5-6 figura kafshësh të ndryshme të pyllit. Të vegjlit duhet të përpiqen që secilën prej pjesëve prej druri me ngjyra të ndezura ta vendosin në folenë e formës së duhur në tabelën bazë. Çdo pjesë e pazëllit prej druri duhet të ketë përmasa të mjaftueshme për ta bërë më të lehtë për duart e vogla që të ngrenë, kapin, ekzaminojnë dhe zëvendësojnë.	12 muaj +	Përmasat e përafërta: Gjat x gjer x lartesi: 330-340x70-80x20-25mm. Ndryshimi i mundshëm ±5%
6	Minipazëll me 5 elementë, kafshët e fermës	Lodër didaktike argëtuese. Pazëll prej druri përmban 5-6 figura kafshësh të ndryshme të fermës. Të vegjlit duhet të përpiqen që secilën prej pjesëve prej druri me ngjyra të ndezura ta vendosin në folenë e formës së duhur në tabelën bazë. Çdo pjesë e pazëllit prej druri duhet të ketë përmasa të mjaftueshme për ta bërë më të lehtë për duart e vogla që të ngrenë, kapin, ekzaminojnë dhe zëvendësojnë.	12 muaj +	Përmasat e përafërta: Gjat x gjer x lartesi: 330-340x70-80x20-25mm. Ndryshimi i mundshëm ±5%

7	Pllaka lëkundëse me magnet	Lodër didaktike argëtuese me material druri me 8-10 elementë. Seti përfshin forma rrethore me magnet, me madhësi dhe ngjyra të ndryshme që vendosen mbi njëra-tjetrën. Secila prej pjesëve prej druri me ngjyra të ndezura përmban një magnet të zgjuar brenda në mënyrë që ato të qëndrojnë fort njëra mbi tjetrën. Fëmijët duhet të vendosin secilën nga pjesët në rendin e duhur sipër bazës prej druri.	12 muaj +	Përmasat e përafërta: Gjat x gjer x lartësi: 100-110x150-170x100-110mm Ndryshimi i mundshëm ±5%
8	Topuz muzikor me ngjyrat e ylberit	Lodër didaktike argëtuese muzikore, e krijuar me material prej druri me anë të harkuara, me ngjyra të forta të ylberit dhe dizeno të përshtatshme për fëmijë. Kur lodra tundet krijon tinguj relaksues për fëmijët. E përshtatshme për latantë dhe pas-latantë.	0 muaj +	Përmasat e përafërta: Gjat x gjer x lartësi: 60-70x80-100x60-70mm. Ndryshimi i mundshëm ±5%
9	Topuz muzikor në formë kafshe të buta (lepuri, ketri, etj)	Lodër didaktike argëtuese muzikore, e krijuar me material prej druri në formë kafshe të butë (lepuri, ketri, etj.). Kur lodra tundet krijon tinguj relaksues për fëmijët. E përshtatshme për latantë dhe pas-latantë.	0 muaj +	Pesha 0.05 kg- 0.1 kg Ndryshimi i mundshëm ±5%
10	Lupë zmadhuese	Lupë zmadhuese e përbërë me kornizë me material druri. E përshtatshme për fëmijë të vegjël. E pajisur me bisht për tu mbajtur. E lehtë në përdorim.	3 vjeç +	Përmasat e përafërta: Gjat x gjer x lartësi: 120x230x15mm Ndryshimi i mundshëm ±5%
11	Veshje e policit	Veshje e profesionit të policit e cila përfshin 5-7 elementë: Jeleku i policit, i përbërë me material pambuk dhe poliester, i rregullueshëm për t'u përshtatur me madhësi të ndryshme për fëmijë të moshës 3-5 vjeç. Seti duhet të ketë edhe mjetet e policit: kapele e policit, distiktiv, radio, pranga, tabelë policie, bllok i policit, etj.	3 vjeç +	E përshtatshme për tu veshur nga fëmijë 3-5 vjeç
12	Veshjet e zjarrfikësit	Veshje e profesionit të Zjarrfikësit e cila përfshin 4-6 elementë: Xhaketa e zjarrfikësit, e përbërë me material pambuk dhe poliester, e rregullueshëm për t'u përshtatur me madhësi të ndryshme për fëmijë të moshës 3-5 vjeç. Seti duhet të ketë edhe mjetet e	3 vjeç +	E përshtatshme për tu veshur nga fëmijë 3-5 vjeç

		zjarrfikësit: helmetë, radio, fikëse zjarri, megafon, etj.		
13	Veshja e mjekut	Veshje e profesionit të mjekut e cila përfshin 5-7 elementë: Xhaketa dhe pantallonat e mjekut të përbëra me material pambuk dhe poliester, të rregullueshëm për t'u përshtatur me madhësi të ndryshme për fëmijë të moshës 3-5 vjec. Seti duhet të ketë edhe mjetet e mjekut: stetoskop, termometër, shiringë, etj. Mjetet e mjekut duhet të jenë më material druri.	3 vjeç +	E pershtatshme për tu veshur nga femije 3-5 vjec
14	Set për mjetet e mjekut	Lodër didaktike argëtuese. Është një kuti ose çantë në të cilën gjenden mjetet e mjekut. Mjetet të jenë material druri dhe kryesisht të ndërtuar me material ndihmës plastik apo metalik për aksesorët, me forma të përshtatshme për mosdëmtimin e fëmijëve.	3 vjeç +	Përmasat e përafërta: Gjat x gjer x lartesi: 280-300x200-220x90-100mm Ndryshimi i mundshëm ±5%
15	Set për mjetet e dentistit	Lodër didaktike argëtuese. Është një kuti ose çantë në të cilën gjenden mjetet e dentistit. Mjetet të jenë material druri dhe kryesisht të ndërtuar me material ndihmës plastik apo metalik për aksesorët, me forma të përshtatshme për mosdëmtimin e fëmijëve.	3 vjeç +	Përmasat e përafërta: Gjat x gjer x lartesi: 210-230x170-180x75-90mm Ndryshimi i mundshëm ±5%
16	Pazëll me numra	Lodër didaktike argëtuese me material druri. Pazëll me 10 elementë. Përfshin numrat, të lëvizshëm, të ndërtuara me material druri të cilat vendosen nga fëmijët në vendet e caktuara.	3 vjeç +	Përmasat e përafërta: 300-310x220-230x15-20mm Ndryshimi i mundshëm ±5%
17	Tavolinë me vegla pune	Lodër didaktike argëtuese. Tavolinë pune, e gjitha prej materialit të drurit. Me ngjyra të forta dhe terheqese për syrin e fëmijëve. Seti duhet të përmbajë mjetet e punës sharrë, çekiç, çelësa, kacavida, vida, bullona, daltë, etj në një set.	3 vjeç +	Përmasat e përafërta: Gjat x gjer x lartesi: 360-270x490-500x250-270mm Ndryshimi i mundshëm ±5%

18	Kub aktiviteti i madh	Lodër didaktike argëtuese. Kub i realizuar me material prej druri ku në të 5-ta faqet e tij të jenë montuar versione të ndryshme lojërash formuese, argëtuese dhe edukative. Format e montuara në faqet anësore të jenë të lëvizshme nga fëmijët. Secila faqe e kubit të ofrojë aktivitete të ndryshme.	12 muaj +	Përmasat e përafërta: Gjat x gjer x lartesi 230-250*380-400*20-25 mm Ndryshimi i mundshëm ±5%
19	Aktivitet lëvizës	Lojë didaktike argëtuese. Shëtitëse prej druri, me rrota, për fëmijë, e mbushur plot me aktivitete argëtuese. Lodra të jetë lëvizshme nga fëmija, të ketë ngjyra të çelura tërheqëse, forma për të argëtuar dhe stimuluar zhvillimin e fëmijëve si mund të jenë: numratorë, pasqyrë, dritare të vogla me figura të ndryshme, etj.	12 muaj +	Përmasat e përafërta Gjat x gjer x lartesi: 330-350x450-550x320-350 mm Ndryshimi i mundshëm ±5%
20	Dajre	Loder didaktike argëtuese. Dajre e realizuar me rreth me material druri, e pajisur me unaza metalike që tringellojnë, e cila bën muzikë dhe shërben për të zhvilluar dashurinë e fëmijeve për muzikën. Të jetë e përshtatshme për fëmijë të vegjël që mund të kapet dhe të mbahet lehtësisht në dorë.	12 muaj +	Permasat e përafërta: Diametri 15-20cm, Thellësia: 4-5cm. Ndryshimi i mundshëm ±5%
21	Daulle	Lodër didaktike argëtuese, instrument muzikor "daulle", e realizuar prej materiali druri, pëlhure dhe material ndihmës metali dhe plastik. Seti përbëhet nga daullja, dy shkopinjtë druri dhe rripi, me anë të të cilit e mban të varur në qafë.	3 vjeç +	Permasat e përafërta: Diametri 20-25 cm Gjerësia: 15-20 cm Ndryshimi i mundshëm: ±5%

Informacion argumentues për hartimin e specifikimeve teknike.

Hartimi i specifikimeve teknike për mjetet didaktike është bërë duke iu referuar shkresës së Drejtorisë së Zhvillimit dhe Kujdesit në D.P.Ç.K, dhe Sektorit të Zhvillimit dhe Kujdesit Psiko-Social për llojet dhe format e mjeteve didaktike për kopshtet dhe çerdhet e Tiranës, grupmoshave për të cilat do të përdoren këto mjete didaktike.

- Ligjin Nr. 10489 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", datë 15/12/2011;
- Ligjin Nr. 10480, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore", datë 17/11/2011;
- VKM nr. 262, datë 03.04.2013 "Për miratimin e rregullit teknik për Sigurinë e Lodrave".

*Për përcaktimin e specifikimeve janë patur parasysh plotësimi i Kërkesave Thelbësore të Sigurisë: **Kërkesat e përgjithshme të sigurisë***

Lodrat nuk duhet të rrezikojnë sigurinë ose shëndetin e përdoruesve ose palëve të treta kur ato përdoren siç është përcaktuar ose në mënyrën e parashikuar, duke pasur parasysh edhe sjelljen e fëmijëve (sidomos në rastin e grupmoshës 6-muaj deri në 6 vjeç)

Kërkesat e veçanta të sigurisë

- 1. Karakteristikat Fizike dhe Mekanike - të jenë të qëndrueshme, mos të kenë pjesë të vogla;*
- 2. Ndezshmëria - të mos ndizen, nëse ekspozohen ndaj flakës të japin një përhapje të ulet të flakës;*
- 3. Vetitë Kimike nivelet e substancave mutagjene kancerogjene (CMR), e 19 metaleve të rënda si Cadmiumi, 55 substancat alergjen;*
- 4. Karakteristikat Elektrike - Jo tension nominal >24 volt , temp të mos shkaktoj djegie, bateritë e fshehura të paksesueshme nga fëmijët;*
- 5. Higjiena - të shmangët risku ndaj infektimit, të mundësohet larja;*
- 6. Radioaktiviteti - sipas legjislacionit për radioaktivitetin.*

Lidhjet e lodrave- duhet të kenë fortësinë e duhur mekanike, qëndrueshmërinë për të përballuar pa risk sforcimet;

Pjesët e mprehta, të ngriturat, kontakti me to të jenë të reduktuara sa më shumë.

Nuk duhet të paraqesin risk lidhur me mbytjen, gëlltitjen nga pjesët e vogla;

Paketimi i lodrave - përmasat e përshtatshme të pacoptueshme për nën 36 muaj;

Lodrat, që japin lëvizshmëri - Sistemi i frenimit duhet të jetë lehtësisht i përdorshëm;

Temperatura maksimale dhe minimale në çdo sipërfaqe të mos shkaktojë dëmtime kur preket (lodrat me bateri, elektrike);

Kufiri i vlerave maksimale të impulsit të zhurmës dhe vazhdueshmërisë së zhurmës së tingullit (lodrat me tinguj, muzikore)

Të reduktojnë mundësisht sa më shumë riskun e shtypjes ose të kapjes të pjesëve të trupit, të rrobave dhe veshjeve, përplasjeve dhe mbytjes. (lodrat aktivizuese) etj

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Llojet dhe sasia e mallit që do të lëvrohet është si më poshtë:

Nr	EMERTIMI	Njesia	Sasia	Brenda dates 15.11.2023	Brenda dates 15.12.2023
1	Shtëpi me forma kafshësh shtëpiake	Copë	100	50	50
2	Kamion me kafshët e pyllit	Copë	250	125	125
3	Pazëll me 8 -10 mjetet e transporti	Copë	250	125	125
4	Minipazëll me 5 elementë, kafshët shtëpiake	Copë	20	10	10
5	Minipazëll me 5 elementë, kafshët e pyllit	Copë	20	10	10
6	Minipazëll me 5 elementë, kafshët e fermës	Copë	20	10	10
7	Pllaka lëkundëse me magnet	Copë	150	75	75
8	Topuz muzikor me ngjyrat e ylberit	Copë	80	40	40
9	Topuz muzikor në formë kafshe të buta (lepuri, ketri etj)	Copë	80	40	40
10	Lupë zmadhuese	Copë	200	100	100
11	Veshjet e policit	Copë	230	115	115
12	Veshjet e zjarrëfikësit	Copë	230	115	115
13	Veshja e mjekut	Copë	230	115	115
14	Set për mjetet e mjekut	Copë	230	115	115
15	Set për mjetet e dentistit	Copë	230	115	115
16	Pazëll me numra	Copë	300	150	150
17	Tavolinë me vegla pune	Copë	90	45	45
18	Kub aktiviteti i madh	Copë	250	125	125
19	Aktivitet lëvizës	Copë	100	50	50
20	Dajre	Copë	100	50	50

21	Daulle	Copë	150	75	75
----	--------	------	-----	----	----

Afatet e lëvrim:

Afati i lëvrim të mallrave do të jetë që nga data e lidhjes së kontratës deri 31.12.2023.
OE do të kryejë lëvrimin e mallit, me kërkesën e AK, sipas përcaktimeve në tabelën e mësipërme, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të

përfiturar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore për vitet financiare 2021, 2022 ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.2. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 2 vitet e fundit financiare 2021, 2022, ku vlera e xhirit për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një

vlere jo me te vogel se 20% e vleres se perlloritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve te fundit.

- Operatori ekonomik per te vertetuar pervojen e meparshme te realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasitë dhe llojin e mallrave të furnizuara.
- Operatori Ekonomik per te vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasitë dhe llojin e mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikatë ISO 9001:2015 lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë të produkteve, ose ekuivalente, të vlefshme, për prodhimin dhe/ose tregtimin e produkteve objekt prokurimi.

2.3.3 OE, për cdo mjet didaktik/lodër duhet të paraqesë “Deklaratë CE të Konformiteti”, në përputhje me standardet e CE.

Deklarata e konformitetit identifikon artikullin për të cilën kjo deklaratë është hartuar.

Në deklaratën e konformitetit të paraqitur duhet të duket qartazi lidhja e produktit të paraqitur, me deklaratën e konformitetit.

2.3.4 OE duhet të paraqesë katalog ose pjesë të katalogut ku të tregohen qartazi lloji i artikullit (lodrës) përmasat dhe të dhënat e prodhuesit.

2.3.5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon 1 (një) automjet qe do te sherbeje per transportin e produkteve objekt prokurimi me masë maksimale të autorizuar 1-1.5 ton, ne pronësi ose ne perdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon 1 (një) automjet, ne pronësi ose ne perdorim sipas kontrates noteriale, te vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- çertifikate pronësie
- siguracion (TPL)
- çertifikatë e kontrollit teknik

Në rastin kur automjeti është me qera/në përdorim, të paraqesë kontratën noteriale përkatëse si dhe dokumentat e kërkuara të automjetit.

2.3.6 Ditën e hapjes së tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një mostër të realizuar sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor dhe sipas deklaratës së konformitetit të depozituar në SPE sipas kriterit 2.3.3.

Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë D.P.Ç.K., Rruga e Barrikadave, Çerdhje nr. 1, Tiranë.

Në secilën lodër duhet të jetë qartazi i dukshëm markimi “CE”.

Markimi CE vendoset në lodër në një etikete të fiksuar në lodër ose në paketimin e saj në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme.

Cdo artikull duhet të jetë i ambalazhuar në ambalazh të personalizuar, në të cilët duhet të duken qartazi emri dhe adresa e prodhuesit.

Në ambalazhin e secilit artikull duhet të jetë etikimi në gjuhën shqipe për:

Emërtimin e mjetit didaktik/ lodrës

Përshkrim i shkurtër i mënyrës së përdorimit.

Materiali përbërës i artikullit (lodrës).

Mosha e këshilluar për përdorim.

Vendi i origjinës

Etiketat e vendosura dhe instruksionet e përdorimit që shoqërojnë artikujt duhet të tërheqin vëmendjen e përdorueseve ose mbikëqyrësve të tyre mbi rreziqet dhe risqet e mundshme të dëmtimit që përfshihen gjatë përdorimit të lodrave si dhe mënyrat mbi shmangiet e rreziqeve dhe risqeve të tilla.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila të përmbajë të dhënat: Mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik. Etiketa e ngjitur nuk duhet të mbulojë të dhënat e kërkuara më sipër.

Mos paraqitja mostrave të kërkuara në vendin, ditën dhe orën e hapjes së ofertave për të gjithë mallrat objekt prokurimi është kusht për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar nëse është në gjuhën shqipe duhet të paraqitet në origjinal ose kopje e noterizuar e njëzuar me origjinalin. Nëse dokumenti është në gjuhë të huaj, duhet të paraqitet i përkthyer nga një përkthyes i licencuar, shoqëruar me vërtetim përkthimi nga Noteri, si dhe i noterizuar/njëzuar kopja me origjinalin nga Noteri.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar, ose paraqitja e dokumentave të rreme, përbën kusht për skualifikim.

Argumentim për hartimin e kriterëve teknike të kualifikimit:

Kriteret teknike të kualifikimit janë hartuar në përputhje të plotë me kërkesat specifike të përcaktuara me ligj:

- *Ligjin Nr. 10489 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", datë 15/12/2011;*

Ky Ligj është mbështetur plotësisht në vendimin nr. 768/2008/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 9 korrik 2008 "Mbi kuadrin e përbashkët për tregtimin e produkteve.

- *Ligjin Nr. 10480, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore", datë 17/11/2011;*
- *VKM nr. 262, datë 03.04.2013 "Për miratimin e rregullit teknik për Sigurinë e Lodrave". Ky VKM është mbështetur në Direktivën 2009/48/EC të Parlamentit Evropian, të datës 1 mars 2012 "Për sigurinë e lodrave" EUR-Lex, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 170 e datës 30.6.2009.*

Kërkesa për çertifikatën ISO 9001:2015, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë të produkteve, ose ekuivalente, të vlefshme, për prodhimin dhe/ose tregtimin e produkteve objekt prokurimi, është vendosur nga AK, pasi kërkon të sigurohet që OE konkurues plotëson kërkesat dhe standardet për instalimin e një sistemi sigurie të produkteve që ai tregëton.

Kërkesa që OE, për cdo lodër duhet të paraqesë "Deklaratë CE të Konformiteti", në përputhje me standardet e CE, është vendosur për të vërtetuar që produktet objekt prokurimi plotësojnë kërkesat cilësore në raport me standardet CE të konformitetit për këto produkte duke marrë në konsideratë moshën e fëmijëve që do të përdorin këto artikuj, si dhe legjislacionin përkatës të sipërpërmendur.

Kërkesa që OE duhet të paraqesë katalog ose pjesë të katalogut ku të tregohen qartazi lloji i lodres, markimi CE dhe të dhënat e prodhuesit është vendosur me qëllim që AK të realizojë kontrollin dhe lidhjen midis specifikimeve teknike të kërkuar për secilën prej produkteve, përmasat e tyre, formën dhe të dhënat e prodhuesit.

Kërkesa që OE të disponojë një automjet me masë maksimale të autorizuar 1-1.5 ton, është vendosur pasi lëvrimi i mallit pranë magazinës të AK do të kryehet në dy kohë dhe për një sasi të konsiderueshme artikujsh, përsa më sipër AK nëpërmjet këtij kriteri do të sigurohet që OE ka kapacitet për të përmbushur nevojat e AK brenda afatit të përcaktuar në grafikun e lëvrimit.

Kërkesa që OE të paraqesë mostra ditën e hapjes së tenderit është vendosur për të vërtetuar lidhjen midis OE konkurrues në raport me mostrën e paraqitur ditën e hapjes së tenderit dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitur në SPE, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit. Gjithashtu për të vërtetuar plotësimin e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike ku mostra e kërkuar do të shfaqë cilësinë e produktit final i cili do të lëvrohet nga OE fitues gjatë gjithë zbatimit e kontrates.

Argumentim mbi hartimin e Fondit Limit:

Fondi limit është përcaktuar referuar:

- *Informacionit për llogaritjen e sasisë së planifikuar për "Blerje mjete didaktike" për çerdhet dhe kopshtet e Bashkisë Tiranë për Vitin 2023.*

- Proçes – Verbalit të Testimit të Tregut.
- Fondit të miratuar nga Bashkia Tiranë.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----

E-mail:	----- ---
---------	--------------

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë (Emër, atësi, amësi, mbiemër, datëlindja, vendlindja, Nr. ID) :</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

<p>Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</p> <ol style="list-style-type: none"> Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate; Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt; Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit; Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përparatur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
--

5. Për qëllim të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë/kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
- paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
- Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- çmimet ;
 - metodat, faktorët ose formulat e përdorur për llogaritjen e çmimit;
 - qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
